



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN  
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 416 Prot

Datë 29.02.2016

AKT PËRPUTHSHMËRIE

Nr. 5, Datë 29.02.2016

PËR DOKUMENTIN E “STRATEGJISË TERRITORIALE”

BASHKIA LUSHNJE

Në mbështetje të neneve 9, 23 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, të VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar në proces hartimi, të Vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit lidhur me përcaktimin e çështjeve, shpalljen e zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare në planifikim, të Strategjive Sektoriale në fuqi, të normave teknike të planifikimit si dhe të dhënave elektronike bazë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për Dokumentin e “Strategjisë Territoriale”, Bashkia Lushnje.
2. Pjesë përbërëse e këtij Akti Përputhshmërie është:
  - “Raporti i Vlerësimit Teknik” i Dokumentit të “Strategjisë Territoriale” të Bashkisë Lushnje.
3. Ngarkohet Bashkia Lushnje të reflektojë rekomandimet e “Raportit të Vlerësimit Teknik”, sipas hapave të përcaktuara në raport.

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

*Adelina Greca*





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN  
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

RAPORTI I VLERËSIMIT  
PËR DOKUMENTIN E “STRATEGJISË TERRITORIALE”

BASHKIA LUSHNJE

29.02.2016



Subjekti i Përputhshmërisë	Përcaktime / Komente / Rekomandime	Përputhshmëria
<p>Përputhshmëria Ligjore</p> <p><b>Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014</b> “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Neni 4, shkronjat a, b, c, ç, dh, f, h, j, ll</li> <li>- Neni 9, pika 1/a, pika 1/c, pika 1/dh, pika 1/f, pika 1/g;</li> <li>- Neni 9, pika 2, shkronjat a, b dhe c/i, c/ii, c/iii;</li> <li>- Nenet 13, 15, 20, 23, 24, 25.</li> </ul> <p><b>VKM Nr. 671, datë 29.07.2015</b> “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Neni 18;</li> <li>- Nenet 49, 50, 51, 52, 53</li> </ul>	<p>Sipas VKM nr. 671, nenit 52, Strategjia Territoriale përmban të paktën:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga PPK-ja, PKS-ja, PSNQ-ja, në fuqi apo proces hartimi, të cilat ndikojnë në territorin vendor;</li> <li>2. Analizën metabolike dhe vlerësimin e përgjithshëm të territorit të njësisë vendore;</li> <li>3. Përcaktimin e territorit në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujqor dhe infrastrukturor;</li> <li>4. Identifikimin e problematikave që rrjedhin nga analiza e mësipërme;</li> <li>5. Vizionin e zhvillimit të territorit të njësisë vendore;</li> <li>6. Objektivat strategjike për zhvillimin e territorit të njësisë vendore;</li> <li>7. Drejtimet për zhvillimin e territorit të njësisë vendore në bazë të treguesve të sistemeve;</li> <li>8. Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit, të cilat pasqyrojnë përparësitë dhe drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit të njësisë vendore dhe mundësojnë realizimin e objektivave strategjike;</li> <li>9. Planin e veprimeve për realizimin e programeve e të projekteve, përfshirë ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore, burimet njerëzore dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e planit të veprimeve;</li> <li>10. Hartat që paraqesin vizionin strategjik të zhvillimit të territorit të njësisë vendore, drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, objektivat dhe fazat kohore të zbatimit të programeve e projekteve;</li> <li>11. Hartën e sistemeve ekzistuese së bashku me tabelën dhe treguesit përkatës për secilin sistem.</li> </ol>	<p><i>Në përputhje</i></p>
<p><b>Plani i Përgjithshëm Kombëtar</b></p>	<p>Bashkia Lushnje është pjesë e zonës funksionale ekonomike Vlorë-Fier-Berat. Mbi bazën e parashikimit të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, kjo zonë do të ketë <b>3 Qendra Parësore</b>, përkatësisht</p>	<p><i>Në përputhje</i></p>



	<p>Bashkinë Vlorë, Bashkinë Fier dhe Bashkinë Berat. <b>Bashkia Lushnje</b> dhe <b>Bashkia Kuçovë</b> parashikohen si <b>Qendra Dytësore</b> të zonës funksionale ekonomike ndërsa bashkitë e tjera do të jenë <b>Qendra Terciare</b>.</p> <p>Orientimet e zhvillimit që rrjedhin nga PPK janë:</p> <p><b>Zhvillimi Urban:</b></p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar vendos BashkiTë Vlorë, Fier dhe Berat si Qendrat Parësore të zonës funksionale ekonomike;</li><li>2. Bashkia Lushnje parashikohet si Qendër Dytësore e zonës;</li><li>3. Nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit funksional midis qendrave parësore urbane, qendrave dytësore, qendrave terciare, qendrave lokale të specializuara, si edhe konsolidimit të infrastrukturës së transportit publik, PPK synon të zbusë trendin humbës të popullsisë;</li><li>4. Sugjeron konsolidimin e zhvillimit urban në qendrat urbane me qëllim frenimin e fenomenit të shperhapjes urbane në dëm të tokës bujqësore;</li><li>5. Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon eficientimin e vend-depozitimeve ekzistuese dhe ndërtimin e vend-depozitimeve rajonale sipas standarteve të kuadrit ligjor sektorial.</li></ol> <p><b>Sistemi Natyror:</b></p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Përgjatë luginave të lumenjve, propozohen korridoret natyrorë, të cilët përcaktojnë si prioritet përdorimi natyrën dhe bëjnë lidhjen me zonat e mbrojtura mjedisore, parqet kombëtare dhe rezervatet natyrore, masivet pyjore etj.;</li><li>2. Propozohet ruajtja dhe shtimi i zonave pyjore duke rritur ndjeshëm sipërfaqet e pyllëzuara;</li><li>3. Duke përmirësuar infrastrukturën ujore (kanalet vaditëse dhe kulluese) PPK synon rritjen efektive të veprimtarisë bujqësore përgjatë të gjithë hapsirave të mundshme për kultivimin e kulturave bujqësore;</li><li>4. PPK në lidhje me përdorimin/shfrytëzimin e lumenjve dhe degëzimeve të tyre, duke vendosur vijën blu synon të arrijë:<ol style="list-style-type: none"><li>a) Mbrojtje nga shfrytëzimi intensiv për nxjerrjen e inerteve në lumenj;</li></ol></li></ol>	
--	---	--

- b) Mbrojtje nga efektet e vend-depozitimeve të mbetjeve urbane;
- c) Mbrojtje nga efektet anësore negative të aktivitetit bujqësor e industrial .

**Sistemi Ujor:**

1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon marjen e masave përkatëse me qëllim reduktimin e ndotjeve industriale apo organike përgjatë të gjitha vijave ujore, rezervuarëve, liqeneve, etj;
2. PPK propozon mbrojtjen e cilësisë së ujrave përgjatë lumit Shkumbin dhe degëzimeve të tij, degëve të lumit Seman, Devoll, si dhe liqenet e Dushkut në Gramsh, 69 liqenet në pllajën e Dumresë dhe 4 liqenet e Rrajcës në Librazhd;
3. Propozon rritjen e bashkëpunimit ndërbashkiak me qëllim mbikqyrjen dhe ruajtjen e florës dhe faunës së pasur ujore dhe mbitokësore;
4. Propozon ruajtjen dhe krijimin e parqeve natyrore përgjatë brigjeve të lumenjve;
5. Propozon ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të përdorur në të gjitha qendrat urbane që shtrihen përgjatë brigjeve ujore.

**Sistemi Bujqësor:**

1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon ruajtjen e hapsirave territoriale të tokës bujqësore duke ndaluar zhvillimet urbane në tokat bujqësore;
2. Propozon ndërmarrjen e politikave nxitëse për bashkëpunimin ndërmjet fermerëve me qëllim krijimin e korporatave/kooperativave të afta për të qënë konkurrese me simotrat e tyre në rajon;
3. Propozon ruajtjen e traditës vendase të kulturave bujqësore, sikurse janë produkti i patates, bostanit, karrotës, vreshtat, pemët frutorë, ullishtet, drithërat, etj;
4. Rekomandon bashkitë përkatëse për marrjen e masave të duhura në aspektin e përmirësimit të rrjetit ujor (kanalet vaditëse / kulluese, etj.);
5. Propozon plotësimin e zinxhirit ekonomiko-bujqësor në agropërpunimin e produkteve bujqësore (prodhim + përpunim + tregtim);



6. Propozon krijimin e tregjeve rajonale bujqësore, ku Lushnja duhet konsideruar si Pol Bujqësor me rëndësi kombëtare. Kjo kërkon parashikimet e nevojshme në instrumentet 'më të ulët' të planifikimit për hapësirat e nevojshme të pikave të grumbullimit, përpunimit dhe transportimit të produkteve bujqësore. Rritjen e cilësisë dhe eficientimin e infrastrukturës që lidh këtë pol bujqësor me qendrat e tjera parësore urbane , dytësore, terciare dhe ato të specializuara.

**Sistemi Infrastrukturor:**

1. Propozon ndërmarrjen e nismave përkatëse me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të energjisë alternative duke synuar krijimin e parqeve fotovoltaike për të shfrytëzuar energjinë diellore atë të erës, etj., në përputhje me karakteristikat e pejzazhit natyror dhe historik, pa e cënuar atë;
2. Propozon studimin e fizibilitetit të potencialeve si dhe riaktivizimin e industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të naftës, gazit natyrorë, etj, në zonën funksionale ekonomike Vlorë-Fier-Berat në përputhje me parimin e ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit;
3. Zhvillimin e qendrës së Vlorës si një Hub Multimodal Ndërkombëtar, nisur nga modalitetet portuale, hekurudhore dhe rrugore që ofron, si dhe zhvillimin e qendrave Fier dhe Berat si Hub- e Kombëtare për të përmbushur nevojat e modaliteteve të brëndshme;
4. Rivlerësimin e akseve ekzistues: Levan- Vlorë dhe Orikum- Llogara, nisur nga fakti që kalojnë përgjatë ose përmes Zonave të Mbrojtura si Parku i Levanit, i Pishë Poros, në Rezervatin Vjosë- Nartë dhe në Parkun e Llogarasë dhe Karaburunit. Ky rivlerësim sugjerohet të kryhet sipas konceptit të Rrugëve Green duke i rehabilituar dhe përshtatur me infrastrukturën specifike;
5. Integrimin e mëtejshëm dhe mirëfunksionimin me kapacitet të plotë të stacioneve aktuale të rrjetit hekurudhor;
6. Rigjallërimin e linjës hekurudhore në tërësi;
7. Propozon rrjetin e biçikletave, i cili përshkon rajonin referuar rrjetit kombëtar të bicikletave propozuar nga PPK. Në këtë zonë funksionale



	<p>ekonomike kalon Itinerari Horizontal Kombëtar;</p> <p>8. Segmente të Itinerarit Horizontal që kalojnë në rajon përshkojnë qendrat turistike në Berat – Lushnje – Karavasta – Manastiri i Ardenicës – Parku i Apollonisë, nëpërmjet një infrastrukture ‘soft’ për biçikletat, si pjesë e itinerarit pejsazhistik me rëndësi për zonën;</p> <p>9. Propozon trajektoren fizike në të cilën mund të kalojë Korridori Blu, ose Itinerari Bregdetar Turistik Kombëtar: Karavasta – Seman – Pishë Poro – Nartë – Orikum – Karaburun – Llogara.</p>	
--	--	--

**Rekomandime për fazat e mëtejshme të hartimit të dokumentit të planifikimit për Bashkinë Lushnje:**

<p>Strategjia, Objektivat, Projektet Prioritare</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbrojtje maksimale të tokës bujqësore duke parë potencialet dhe drejtimin që ka kjo bashki në këtë sektor;</li> <li>- Përputhja e rekomandimeve të evidentuara nga analiza SWOT me projektet strategjike prioritare për të siguruar efikasitet më të lartë të veprimit në territor;</li> <li>- Fazimi i strategjisë dhe objektivave duke patur parasysh një territor në ndryshim të vazhdueshëm, i cili në harkun e 15 viteve në vijim do të ketë zhvillime e nevoja të tjera. Një parashikim i skenareve të mundshme për këtë hark kohor do ndihmonte identifikimin e problemeve/presioneve të ardhshme dhe kundërpërgjigjeve për zgjidhjen e drejtimin e tyre sidomos në sektorin bujqësor;</li> <li>- Detajimi i projekteve prioritare (fishave) edhe me kosto (të përafërta), në mënyrë që të bëhen sa më të prekshme për financues të mundshëm dhe të arrihet në një plan veprimi prioritar paraprak që i shërben Bashkisë;</li> <li>- Monitorimi i zbatimit të strategjisë dhe objektivave kërkon një sërë treguesish të matshëm, të cilët mund të evidentohen në fazat më të avancuara të PPV.</li> </ul> <p>Sugjerime që rrjedhin nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• PPK, përtej detyrimit për vendosjen e tregjeve bujqësore rajonale, në zonën funksionale ekonomike Vlorë – Fier - Berat përcakton gjithashtu <b>Bashkinë Lushnje si një hub bujqësor me rëndësi kombëtare.</b></li> <li>• Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë Lushnje duhet të shprehet dhe të argumentojë mbi Itinerarin alternativ Kashar - Peqin që propozon, duke qënë se Planet Kombëtare nuk shprehin propozime për këtë aks.</li> <li>• Përsa i përket hartave, të cilat janë referuar nga propozimet e Planeve Kombëtare duhet të merren në konsideratë paraqitja e:             <ul style="list-style-type: none"> <li>– Lidhjes me rrugë interurbane kryesore midis Lushnjës, Urës</li> </ul> </li> </ul>
---	---



	<p>Vajgurore, Kuçovës dhe Beratit, pasi është evidentuar rishtazi vetëm lidhja e rrugëve interurbane dytësore Fier – Rroskovec – Urë Vjagurore – Berat.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Aksit rrugor Kardhiq – Delvinë, pjesë e Boshtit Qëndror – Jugor.</li> <li>- Aksi rrugor përgjatë lumit të Drinos, si një rrugë e parametrave interurbanë dytësorë.</li> </ul>
<p>Planifikimi sipas sistemeve territoriale</p>	<p><b>Sistemi Infrastruktural, fokus në:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërmarrja e nismave përkatëse me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të energjisë alternative si ajo diellore (parqet fotovoltaike) apo energjia e erës, etj. në sektorin e bujqësisë dhe jo vetëm;</li> <li>- Ndërtimin e stacionit multimodal dhe lidhja e tij me rrjetin e transportit.</li> <li>- Aktivizimi i zonave të mbrojtura (natyrore dhe kulturore) si potenciale turistike nëpërmjet projekteve ‘soft’, që lidhin zonat natyrore dhe kulturore me fshatrat përgjatë tyre.</li> </ul> <p><b>Sistemi Natyror dhe Bujqësor, fokus në:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Evidentimin e masave për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike duke patur parasysh sidomos përmbytjet, thatësitat dhe motin ekstrem, në harkun kohor 15-vjeçar të veprimit të PPV;</li> <li>- Mbrojtjen e sistemit natyror nga ndotjet që mund të vijnë nga sistemi urban, industrial dhe bujqësor.</li> </ul> <p><b>Sistemi Ujor dhe Urban, fokus në:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nevojat aktuale dhe ato në rritje të popullsisë për furnizimin me ujë;</li> <li>- Nevojat aktuale dhe ato në rritje të sistemit të bujqësisë për furnizimin me ujë;</li> <li>- Identifikimin e nevojës reale për pajisjen me infrastrukturën e duhur të shërbimeve publike dhe lidhjen e tyre me zonat e tjera administrative; trajtimin e varrezave të qytetit;</li> <li>- Rehabilitimin e hot-spotëve (vatrave të nxehta mjedisore) ekzistuese dhe marrëdhënien e tyre me ndërhyrjet e reja, duke përmendur këtu ish-fabrikën e plastmasit dhe ish-fabrikën e letrës;</li> <li>- Rehabilitimin e vend-depozitimit aktual të mbetjeve dhe lidhja e menaxhimit të mbetjeve urbane me landfillin rajonal.</li> </ul>





Bazuar në VKM-në Nr. 671, dt. 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", materialet që duhen dorëzuar/botuar në Regjistrin e Integruar të Territorit përpara miratimit të dokumentit të **Strategjisë Territoriale**, janë:

- I. **Nisma e miratuar** dhe vendimi i miratimit nga Këshilli Bashkiak;
- II. Dokumentet përbërëse të **Strategjisë Territoriale**, ku do të përfshihen:
  1. **Hartat**
  2. **Relacionin shpjegues**
- III. **Akti i përputhshmërisë** nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

#### E RËNDËSISHME

**Dokumentet zyrtarë për miratim në Këshill Bashkiak dhe KKT janë:**

**HARTAT**, të cilat duhet të paraqesin të paktën:

- a) Përcaktimin e territorit në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujor dhe infrastrukturor;
- b) Vizionin strategjik të zhvillimit të territorit të njësisë vendore;
- c) Drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit;
- d) Objektivat dhe fazat kohore të zbatimit të programeve e projekteve.
- e) Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit.

**RELACIONI SHPJEGUES**, i cili duhet të përmbajë të paktën:

- a) Vizionin e zhvillimit të territorit të njësisë vendore
- b) Objektivat strategjike për zhvillimin e territorit të njësisë vendore;
- c) Drejtimet për zhvillimin e territorit të njësisë vendore në bazë të treguesve të sistemeve;
- d) Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit, të cilat pasqyrojnë përparësitë dhe drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit të njësisë vendore dhe mundësojnë realizimin e objektivave strategjike;
- e) Planin e veprimeve për realizimin e programeve e të projekteve, përfshirë ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore, burimet njerëzore dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e planit të veprimeve.

